



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1548 Prot.

Tiranë, më datë 01.11.2021

VENDIM
Nr. 625, datë 01.11.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.11.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Potencialit Arkeologjik të realizuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Skënder Muçaj, në kuadër të projektit “Objekt banimi dhe Shërbimi 12, 13 kate me 1 kat nëntokë”, në rrugën “Dalip Peza”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit, me aplikues “Pajtoni” sh.p.k. dhe zhvillues Bashkia Durrës;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Në zbatim në Vendimit Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe të Planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, Neni 5, Pika 5, të realizohet monitorimi arkeologjik nga DRTK Tiranë, e cila duhet të raportojë pranë Sekretarisë Teknike të IKTK-së;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së dhe DRTK Tiranë;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

